



Asociacioni i Komunave të Kosovës

**NARRATIV
RAPORTI
PROGRESIT
2017**

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Aktivitetet e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) në vitin 2017 ishin të bazuara në Planin Strategjik të AKK-së për vitin 2016-2020, Planin Vjetor 2017 si dhe në agjendën legislative e prioritetet vjetore të përcaktuara nga strukturat udhëheqëse.

Qëllimi i përgjithshëm vazhdon të jetë, të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e komunave anëtare duke ofruar shërbime për të përmirësuar performancën e tyre, nëpërmjet konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të AKK-së dhe duke siguruar performancë të mirë financiare.

Viti 2017 në Kosovë u karakterizua me zgjedhje qendrore dhe lokale. AKK-ja, përveç ligjeve dhe akteve të shumta nën/ligjore, si prioritet zgjodhi këto projekt-ligje:

- Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës,
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal [të cilin qeveria vendosi të mos ta shqyrtonte në 2017],
- Ligjin mbi Tatimin në Pronë,
- Ligjin mbi Partneritetin Publiko Privat,
- Ligjin mbi E prokurimin.¹

Lobimi dhe Avokimi: Çështjet e suksesshme të vitit 2017

Gjatë vitit 2017 AKK-ja ka marrë pjesë në një numër të madh takimesh të grupeve punuese të ndryshme qeveritare dhe komisioneve parlamentare me qëllim të dhënies e vërejtjeve dhe sugjerimeve si dhe shqyrtimin e projektligjeve gjatë shqyrtimit të legjislacionit.

Në mes numrit të madh të aktiviteteve lobuese dhe avokuese gjatë vitit 2017, shumë prej tyre në baza ad-hoc/urgjente të detajuara në këtë raport, 5 rastet e mëposhtme të suksesshme të lobimit meritojnë vëmendje të veçantë pasi që ato ndikojnë drejtpërdrejt në çështjet financiare dhe menaxhuese të komunave:

1. Ndryshimi i Koncept-Dokumenti për Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Ndryshimi është ndërmarrë pas lobimit intensiv të AKK-së bazuar në kërkesat e komunave anëtare. Ndryshimi i këtij ligji do të ofrojë më shumë mundësi për zhvillim ekonomik në interes të qytetarëve. Bazuar në rekomandimet e AKK-së, ky ndryshim komunave do të ju lehtësojë procedurat për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me bizneset që përqendrohen në punësimin e të rinjve dhe performancën e përgjithshme ekonomike. AKK-ja konsideron që me këto ndryshime komunat do t'a kenë më lehtë në të ardhmen për të bërë më atraktiv ambientin për investime të huaja dhe vendore.²

2. Autonomia Financiare e Komunave

Pas lobimit të vazhdueshëm për rishikimin e Ligjit për Buxhet për 2018, AKK arriti që të eliminojë nevojën për leje nga Ministria e Financave për ndryshim të destinimit të mjeteve të alokuara nëse këto ndryshime

¹ Siç është cekur më lart, AKK-ja në fillim të çdo viti përmes strukturave qeverisëse përcakton prioritetet me të cilat do të mirret vitin e ardhshëm. Zhvillimet varen (lidhur me legjislacionin) mbi aktivitetet e Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Disa nga ligjet e përcaktuara si prioritetet e AKK-së për 2017, Qeveria nuk ka vazhduar me procedim të mëtutjeshëm.

² Më gjerësisht për kontekstin, ndikimin dhe të arriturat në lidhje me këtë çështje, faqe 6, paragrafi 4.3.

kalojnë 25%. Gjithashtu, janë rishikuar procedurat e punësimit të punëtorëve të rinj në komuna. Deri më tani, MF dhe MAP, kanë kontrolluar në mënyrë strikte numrin e të punësuarve në komuna, stafi i ri nuk mund të punësohet pa pëlqimin e këtyre dy ministrive edhe në rastet kur komunat kanë pasur buxhet dhe vende të lira pune. AKK-ja ka arritur të heqë këtë kufizim nga procedurat e punësimit³.

3. Zbatimi i Udhëzimit Administrativ nr. 14/2015 për ndëshkimet dhe gjobat mandatore

Udhëzimi Administrativ u miratua para dy viteve, edhe pse ende nuk ka filluar së zbatuari. Bazuar në iniciativën e përbashkët në mes të AKK-së, MMPH-së dhe Policisë së Kosovës, janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për zbatimin e udhëzimit për reduktimin e ndotjes së mjedisit. Për këtë arsye, të ardhurat që rrjedhin nga këto gjoba të cilat i shqipton inspektori komunal do të shkojnë në komuna, që rrjedhimisht nënkuptohet se ato mjete do të ju kthehen përsëri qytetarëve pasi ato do të përdoren për rregullimin dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbërta dhe mirëmbajtjen e mjedisit në përgjithësi⁴.

4. Akademia për Vetëqeverisje Lokale

Edhe pse është parashikuar në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, AKK-ja ka lobuar kundër planit për themelimin e Akademisë për Vetëqeverisje Lokale. Arsyetimi ishte se ky plan konsiderohej dyfishim i punës së institucioneve ekzistuese siç është Instituti Kosovar i Administratës Publike dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës; që të dy institucionet të parapara me ligj që të ofrojnë shërbime për ngritjen të kapaciteteve në nivelin komunal. Po ashtu themelimi i një Akademie të re do të ishte ngarkesë shtesë për buxhetin e Kosovës⁵.

5. Ndarja e fondit të veçantë për qentë endacak

Si rezultat i përpjekjeve të AKK-së pas një debati që përfshinte përfaqësues të ndryshëm në tejkalimin e situatës rreth qenve endacak, AKK-ja përmes lobimit të vazhdueshëm me Ministrinë e Financave ka arritur që të ndajë një fond të veçantë prej € 1.3 milion euro gjatë shqyrtimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në buxhetin e miratuar për vitin 2018, fondet do të përdoren për të mbështetur planin e veprimit të menaxhimit dhe kontrollit të qenve endacak⁶.

Performanca Organizative

AKK-ja ka respektuar plotësisht obligimet statutores:

Është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor, (ii) Bordi ka mbajtur 6 takime formale dhe disa jo-formale dhe Këshilli i AKK-së është takuar më shumë se 5 herë gjatë këtij viti.

Kolegji i Profesionale – mbeten një mbështetje e fortë në diskutimin e projektligjeve dhe akteve të ndryshme nënligjore në interes të komunave, të cilat veçohen në strategjinë legislative. Këto mekanizma janë struktura unifikuese të pushtetit lokal në Kosovë. Kolegji i Profesionale merren me shqyrtimin dhe diskutimin e

³ Më gjerësisht për kontekstin, ndikimin dhe të arriturat ne lidhje me këtë çështje, faqe 7, paragrafi 4.4.

⁴ Më gjerësisht për kontekstin, ndikimin dhe të arriturat ne lidhje me këtë çështje, faqe 8, paragrafi 4.5.

⁵ Më gjerësisht për kontekstin, ndikimin dhe të arriturat ne lidhje me këtë çështje, faqe 9, paragrafi 4.6.


⁶ Më gjerësisht për kontekstin, ndikimin dhe të arriturat ne lidhje me këtë çështje, faqe 9-10, paragrafi 4.7.

temave të ndryshme me interes komunal, duke përfshirë nxjerrjen e rekomandimeve dhe kërkesave për qeverinë qendrore me qëllim të përmirësimit të shërbimeve komunale.

Secili Kolegji i AKK-së harton planin e saj vjetor i cili përfshin prioritetet, angazhimet dhe objektivat, bazuar në agjendën legislative të qeverisë qendrore. Pavarësisht se 2017 ishte një vit zgjedhor, secili kolegji ka mbajtur së paku 6 takime ndërsa janë mbajtur më shumë se 50 takime të kryesive të Kolegjiemeve. Janë zhvilluar së paku dy qëndrime për secilin Kolegji⁷.

Performanca financiare

Në aspektin financiar, gjatë vitit 2017 AKK-ja ka arritur që të inkasojë € 134,871 nga taksa për anëtarësim, dhe ka realizuar 97 % të objektivit të paraparë prej € 140,000 të planifikuar për këtë vit. Kjo mund të konsiderohet një e arritur duke marrë parasysh që viti 2017 u karakterizua me zgjedhje lokale dhe qendrore, duke penguar kështu rrjedhën normale të ngjarjeve, e megjithatë AKK ka arritur që të ruajë kontinuitetin optimal në realizimin e këtij objekti. SDC vazhdoi të japë kontributin e saj thelbësor në AKK, si partner kryesor institucional. (*Shih tabelën më poshtë*)



Komunikimi dhe menaxhimi i raporteve me komunat

Gjatë gjithë vitit, AKK-ja ka vazhduar të mbajë kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në përgjithësi, komunave u janë dërguar 96 njoftime të ndryshme, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj. Uebfaqja e AKK-së është azhuruar në baza ditore ku të gjitha lajmet dhe aktivitetet e AKK-së janë vendosur rregullisht në faqen e Facebook si dhe gjithashtu është bërë publikimi dymujor i Buletinit të AKK-së. Uebfaqja është vizituar më shumë se 47,000 herë dhe janë publikuar në 'facebook' mbi 60 postime me 1500 deri në 2500 'shikime' për postim.

Bashkëpunimi me partnerë, AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, si dhe në realizimin e shumë projekteve ku komunat kanë përfutur drejtpërdrejtë qoftë në fonde, përkrahje financiare, projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime, punëtori, shkëmbim të përvojave etj.

⁷ Më gjerësisht për aktivitetet e Kolegjiemeve të AKK-së shih kapitullin numër (5) paragrafi 5.1. faqet 10-15

Projektet u impelmentuan në bashkëpunim me DEMOS, GIZ, NALAS, OSBE, TEAM/USAID, UNDP, UNICEF, GIZ/Open Regional Fund and European Commission. AKK-ja ka vazhduar t'i përfaqësoj qëndrimet dhe interesat e komunave dhe të kontribuoj tek koordinimi i donatorëve me pjesëmarrjet e rregullta në takimet e Komitetit Drejtues të projekteve të rëndësishme të donatoreve në fushën e Qeverisjes Lokale dhe Shërbimeve Komunale, siç janë SDC/DEMOS, SDC/RWSSP, GIZ/SMS, etj.

Përveç kësaj, janë organizuar takimet “Miqtë e AKK-së” më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët punojnë në fushën e qeverisjes lokale.

Në përfundim, fushata e trajnimit të anëtarëve të rinj të Kuvendeve të Komunave filloi në fund të vitit 2017 dhe trajnimi do të përfundojë në vitin 2018.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së PËR VITIN 2017

Në vitin 2017, Asociacioni i Komunave të Kosovës ndoqi objektivat e saj bazuar në Strategjinë e re 2016/2020 dhe Planin Vjetor të AKK-së. Objektivat kryesore për vitin 2017 ishin:

- Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të komunave përmes Lobimit dhe Avokimit,
- Ofrimi i shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimi i performancës së Komunave,
- Funksionaliteti i strukturave të AKK-së,
- Qëndrueshmëria financiare,
- Bashkëpunimi me partnerët duke mbajtur AKK si pikë-referim,
- Komunikimi me komunitet dhe përmirësimi i performancës të administratës së AKK-së.

3. ZHVILLIMI DHE KONSOLIDIMI I POLITIKAVE (QËNDRIMEVE)

Në vazhdim të procesit të deritanishëm, Asociacioni i Komunave të Kosovës synoi që përmes strukturave të saj sikurse janë: Bordi, Këshilli i Kryetarëve, Kolegji dhe Komisionet, të konsolidojë qëndrimet e veta karshi institucioneve qendrore me synim zhvillimin e politikave të cilat do të ndihmonin në fuqizimin e rolit të vazhdueshëm të komunave.

Në këtë vit, lobimi i AKK-së ka qenë i përqendruar në disa çështje me prioritet për komunitet sikurse janë: (1) Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, (2) Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, (3) Ligji mbi Tatimin në Pronë, (4) Ligji mbi Partneritetin Publiko Privat dhe (5) Ligji mbi e-prokurimin.

Në të njëjtën kohë është punuar me konsolidim të qëndrimeve të komunave edhe në çështjet ad-hoc si aprovimi i kodit të veçantë për mbeturina, aprovimi i buxhetit për trajtimin e qenve endacak në kornizën afatmesme buxhetore (KAB) për komunitet dhe kërkesa për shtyrje të afatit në dërgimin e KAB-it nga komunitet ne Ministrinë e Financave.

Në këtë drejtim, AKK-ja rregullisht ka takuar Bordin dhe Kolegji për të diskutuar planet vjetore të punës, prioritetet e angazhimeve dhe synimeve bazuar në agjendën legjislativ të Qeverisë Qendrore. Në kuadër të planeve vjetore të Kolegji ka vazhduar të trajtohet me seriozitet angazhimet e vazhdueshme në implementimin e strategjive të Kolegji. Një çështje tjetër e rëndësishme për t'u përmendur është Strategjia e re e AKK-së 2016/2020.

4. LOBIMI DHE AVOKIMI

4.1. Lobimi

AKK-ja edhe në vitin 2017 ka vazhduar aktivitetet e saj në lobim si shtylla kryesore dhe më me ndikim tek autoritetet komunale.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, sfida për AKK është paraqitur çështja që Kosova hyri në zgjedhje të parakohshme. Institucionet e vendit - Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, nuk e kanë realizuar agjendën

legjislative dhe aktivitetet tjera sipas planit të punës. Kjo ka ndikuar edhe në planin e punës së AKK-së, pasi realizimi i planit të punës tonë varet nga procedimi i ligjeve së pari nga Qeveria e pastaj nga Kuvendi.

Megjithatë, ministritë e linjës kanë proceduar një numër të madh të akte nënligjore, të cilat janë ndërlidhur me zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me kompetencat e komunave, andaj AKK-ja i ka shqyrtuar të gjitha në Kolegjiunet profesionale dhe ka dhënë rekomandimet adekuate.

Po ashtu në rastet kur aktet nënligjore kanë përmirësuar ndonjë fushë specifike të kompetencave të komunës, në takimet e Kolegjiuneve janë ftuar edhe përfaqësuesit e ministrive të linjes, ku përfaqësuesit e komunave kanë kërkuar sqarime nga ana e përfaqësuesëve të ministrive, për nene të caktuara të ligjeve si dhe kanë pasur rastin për të argumentuar mbi to.

4.2. Koncept-Dokumenti për Projektligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

Konteksti

Që nga viti i kaluar, AKK-ja kërkoi ndryshimin e këtij ligji në mënyrë që të mund të ofroj një qasje më të arsyeshme dhe më të plotësuar. Përmes një udhëzimi të ri administrativ, Qeveria ndryshoi procedurat për hartimin e një ligji, duke kërkuar fillimisht një koncept-dokument i cili do të arsyetojë kërkesën për ndryshim dhe të ofrojë tri (3) opsione lidhur me ligjin i cili kërkohet të ndryshohet. Andaj me iniciativën e AKK-së, MAPL-ja filloj procedurat e hartimit të koncept-dokumentit, ku AKK-ja është përfshirë në grupin e punës dhe përmes anëtarëve tanë kemi paraqitur qëndrimet dhe kërkesat e komunave. Ky koncept dokument i ka kaluar të gjitha procedurat në Qeveri, dhe me datën 07.04.2017, Qeveria ka nxjerr Vendim nr.03/141, ku ka aprovuar Koncept-Dokumentin për hartimin e Projektligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Pas miratimit të Koncept dokumentit, MAPL-ja ka vazhduar me procedurat e hartimit të projektligjit. Për më tepër, AKK-ja ka paraqitur rekomandimet e saja dhe përkundër rezistencës së nivelit qendror AKK-ja ka arritur që me sukses të argumentojë të gjitha rekomandimet. Pas pranimit të të gjitha rekomandimeve tona, projektligji është miratuar nga Qeveria dhe tani pritet procedimi në Kuvend të Kosovës.

Të arriturat

Vetë fakti se AKK-ja arriti të jepte kontributin e vet për këtë koncept dokument është një arritje. Në dokumentin, i cili është miratuar nga qeveria, AKK-ja inkorporoi kërkesa të shumta të komunave. E arritura më e madhe është që ky ligj do të ndryshojë (pas një kohe të gjatë pune dhe angazhimi të AKK-së), ndërsa Asociacioni i Komunave ka paraqitur rekomandimet konkrete që duhet të merren parasysh, të cilat në fakt ishin edhe qëllimi kryesor pse ligji duhej ndryshuar.

Është e rëndësishme të theksohet se AKK-ja ka përkrahur opsionin tre (3), i cili thekson se duhet të hartohet një Ligj i ri, i cili duhet të përmbajë në vete çështjet kyçe si: - Procedurat e përzgjedhjes së investitorit privat, - Procedurat për negociim të marrëveshjeve dhe rrethanat kur mund të negociohen ato pa procedura konkurruese, - Ndërtimi i një sistemi elektronik të regjistrimit të pronave të paluajtshme komunale dhe përcaktimi i destinimit të tyre, - Dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për qëllim të ndërtimit të hapësirave banuese kolektive për qëllime sociale.

Prandaj, MAPL ka nxjerr vendimin nr.168-730, datë 11.05.2017, dhe ka formuar grupin punues në të cilin AKK-ja ka përfaqësuesin e vet, për hartimin e Projektligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Projektligji do të zbatohet plotësisht në praktikë pasi që janë marrë parasysht të gjitha kërkesat e komunave pas insistimit tonë dhe angazhimit të madh që kemi treguar në grupin punues.

Impakti

Qëllimi kryesor i komunës është zhvillimi ekonomik si një interes publik, andaj ky ligj do të ju jep mundësi më të madhe për një zhvillim ekonomik më të avancuar, e në anën tjetër gjithashtu do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e shkallës së papunësisë, veçanërisht për gjeneratat e reja. Kjo do të jetë e mundur përmes krijimit të vendeve të reja të punës nga bizneset vendore dhe gjithashtu nga investimet e huaja, veçanërisht nga diaspora kosovare. Duke marrë parasysht rekomandimet e AKK-së, ndryshimi i këtij ligji do të lehtësojë procedurat për komunat dhe do t'u mundësojë atyre të krijojnë më shumë marrëdhënie kontraktuale me bizneset të cilat do të ndikonin në zhvillimin e komunës, në punësim e të rinjve dhe në performancën e komunës në përgjithësi. AKK-ja konsideron që me këto ndryshime komunat do t'a kenë më lehtë në të ardhmen për të bërë më atraktiv ambientin për investime të huaja dhe vendore. Ne besojmë se këtë vit do të miratohet ky ligj, pasi që MAPL-ja vendosi të formoj grupin punues ku AKK-ja është anëtare dhe do të jep kontributin maksimal që komunat ta kenë një ligj të ri dhe më të avancuar. Sapo ligji të miratohet nga qeveria, do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Kosovës. Presim që ligji të hyj në fuqi në vitin 2018 dhe se do të lehtësojë në masë të madhe punën e zyrtarëve komunalë.

4.3. Autonomia Financiare e Komunave

Konteksti

Ministria e Financave (MF) ka ndërhyrë në autonominë financiare të komunave duke vendosur 'kodin pesë shifror' për komuat, me anë të të cilit komunave u kërkohej leje fillestare nga MF në rast të ndryshimit të destinimit të alokimeve të planifikuara nga një linjë buxhetore në tjetrën nëse këto ndryshime kalojnë 25% të shumës së alokuar. Gjithashtu deri këtë vit MF dhe MAP, kanë kontrolluar në mënyrë strikte numrin e të punësuarve në komuna, duke mos lejuar komunat të punësojnë staf të ri pa pëlqimin e këtyre dy ministrive edhe në rastet kur komunat kanë buxhet dhe vende të lira pune. AKK që nga fillimi i vitit 2017 ka filluar procesin e lobimit me moton "Mos shkëlmi në autonominë lokale" duke i sygjyeru akterët institucional për të hequr këto dy nene nga Ligji i Buxhetit të Kosovës 2018. Për më tepër, komunat e Kosovës do të kenë autonomi të plotë në vendimmarrje sa i përket alokimit të mjeteve financiare në buxhetet komunale. Ata mund të punësojnë staf të ri nëse kanë fonde të mjaftueshme financiare të parashikuara në buxhetin komunal, por nuk duhet të tejkalojnë numrin e përgjithshëm të shërbyesve civil të paraparë me ligjet përkatëse të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Të arriturat

AKK-ja në vazhdimësi ka diskutuar çështjet kyçe për autonomi financiare komunale me përfaqësuesit e komunave, të cilët kërkonin autonomi më të madhe me qëllim të rritjes së efikasitetit. AKK ka lobuar tek ministrinë përkatëse dhe ka paraqitur shqetësimet dhe nevojën e komunave për më shumë autonomi në këtë

aspekt. Këto kërkesa janë marrë parasysh nga MF dhe MAP dhe kështu komunave u është lejuar që ndryshimet në buxhet të bëhen sipas nevojave ad-hoc të tyre pa kaluar nëpër burokraci shtesë. Për më tepër, në të ardhmen, komunave do të u lejohet të vendosin vetë për vendet e lira të punës që mund të ketë komuna si rrjedhojë e ndryshimeve të mundshme në numrin e personelit të punësuar.

Impakti

Këto dy fusha shumë të rëndësishme në menaxhimin financiar të komunave do të kenë ndikim të drejtpërdrejt në funksionimin më efikas të komunave, duke e rritur cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve të tyre, si dhe buxheti do të shpenzohet në mënyrë më racionale. Gjithashtu, rëndësia e këtij ndryshimi në procedura është që punësimi i personave të rinj në komuna do të ndikoj në performancën më të avancuar të tyre dhe një autonomi e ofruar komunave në punësim do të zvogëloj nevojën për punësime me ‘kontrata mbi vepër’ nga komunat.

4.4. Udhëzimi Administrativ (UA) nr. 14/2015 për Ndëshkimet dhe Gjobat Mandatore

Konteksti

Edhe pse ky udhëzim është miratuar para dy viteve, ende nuk ka filluar së zbatuari në praktikë. Prandaj, AKK-ja, në bashkëpunim me MMPH-në dhe Policinë e Kosovës, ka organizuar disa aktivitete që kanë për qëllim të promovojnë zbatimin e këtij udhëzimi që merret me pastrimin e mjedisit.

Qëllimi i këtij udhëzimi është parandalimi i hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara nga ana e qytetarëve, eliminimi dhe reduktimi i ndotjes, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mbrojtja e të gjitha sipërfaqeve publike përmes menaxhimit të duhur të mbeturinave.

Komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave që kryhet në bashkëpunim me ndërmarrjet publike. Në rastet kur nuk respektohen rregullat e përcaktuara për këtë fushë nga personat fizik ose juridik ato ndëshkohen me gjoba mandatore. Për këtë arsye, ky udhëzim do të rregullon procedurat dhe do të caktojë vlerat e gjobave për çdo shkelje.

Të arriturat

E veçanta e këtij udhëzimi është se për vendosjen e gjobave janë kompetente tri institucione të vendit: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (përmes inspektorit të mjedisit), Komuna (përmes inspektorit të mjedisit apo inspektorit i cili autorizohet nga kryetari i komunës) dhe Policia e Kosovës. Shqiptimi i dënimit do të bëhet në vendin ku ndodh shkelja e udhëzimit. Me qëllim të arritjes së qëllimit të këtij udhëzimi duhet të ketë kontrolle më të shpeshta. Të gjitha ndëshkimet shqiptohen me gjobë e cila renditet nga 5 € deri në 100 €, ndërsa urdhërpagesat lëshohen në afat prej 7 ditësh.

Impakti

Zbatimi i këtij akti ligjor, përveç tjerash, do të mundësoj parandalimin e ndotjes së mjedisit, menaxhimin më të mirë të mbeturinave, ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe krijimin e një ambienti më të pastër për jetesë. Për më tepër, mjetet materiale të inkasuara nga këto gjoba do të iu shkojnë komunave në rastet kur gjobën e shqipton inspektori i komunës. Kjo nënkupton se të ardhurat e mbledhura do të kthehen tek qytetarët dhe

do të përdoren për të rregulluar hapësirat e gjelbra, zgjerimin e këtyre hapësirave dhe për të pastruar mjedisin. Qytetarët duhet të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave dhe çështjeve të tjera që dëmtojnë shëndetin tonë dhe mjedisin në të cilin jetojmë. Paraprakisht para vendosjes së gjobave i cili konsiderohet si hapi i fundit që duhet të ndërmerret, do të ketë aktivitete të ndërgjegjësimit publik për të informuar qytetarët për rëndësinë e ruajtjes së një ambienti të pastër.

4.5. Akademia për Vetëqeverisje Lokale

Konteksti

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka filluar hartimin e Koncept Dokumentit për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale, e cila është paraparë në Strategjinë për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026, si një objektiv i përfshirë në Planin e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Të arriturat

AKK që në fillim të punës së grupit punues në këtë koncept dokument ka reaguar ndaj një iniciative të tillë duke e konsideruar atë të pa nevojshme dhe si dyfishim i punës së institucioneve ekzistuese relevante për këtë fushë, siç është Instituti Kosovar i Administratës Publike dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Të dy oraganizatat si IKAP dhe AKK-ja sipas ligjit konsiderohen si institucionet kryesore të cilat ofrojnë shërbime për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal. Po ashtu themelimi i një Akademie të re do të ishte ngarkesë shtesë për buxhetin e Kosovës. Duke u bazuar edhe në studimet e zhvilluara rreth asaj se kush duhet të ofroj shërbime për ngritje të kapaciteteve në nivelin lokal në Kosovë (i hartuar nga SDC), kjo problematikë është ngritur edhe me donatorët e përfshirë në këtë çështje. Si rezultat i kësaj, rekomandimet e AKK-së janë pranuar duke çuar në ndalimin e procesit të mëtutjeshëm rreth themelimit të kësaj akademie.

Impakti

Reagimi në kohë i AKK-së ndaj kësaj iniciative dhe roli i saj si kujdestar parandalues i zhvillimeve të cilat nuk janë në harmoni me qëllimet e avancimit të pushtetit lokal në Kosovë, ka tërhequr vëmendjen e institucioneve përkatëse të thirrura për ngritje të kapaciteteve në Kosovë. Këto reagime kanë bërë që komuniteti i donatorëve të qeverisjes lokale të jetë në dijeni për iniciativat që do të dyfishonin aktivitetet ekzistuese në këtë fushë dhe do të ishin një barrë e panevojshme për buxhetin në përgjithësi. Reagimi parandalues i AKK-së ka hasur në vëmendjen e institucioneve përkatëse dhe të donatorëve dhe si rezultat formimi i kësaj Akademie është ndaluar. Poashtu, propozimi për krijimin e një akademie të tillë synon që të zvogëlojë rolin e AKK-së në fushën e ngritjes të kapaciteteve për komunat e Kosovës.

4.6. Çështja e qenve endacak

Konteksti

Duke marrë në konsideratë problematikën e vazhdueshme në menaxhimin e rrezikut nga qentë endacak në të gjitha komunat e Kosovës, kjo çështje po bëhet një shqetësim në rritje nga dita në ditë. Meqenëse autoritetet përgjegjëse lokale e qendrore nuk kanë një zgjidhje efikase për tejkalimin e kësaj situatë dhe për shkak të kufizimeve financiare për kujdesin ndaj këtyre kafshëve, qentë endacakë vazhdojnë të trembin, të lëndojnë dhe madje të marrin jetën e disa qytetarëve. Asociacioni i Komunave të Kosovës nxiti një debat me

qeverinë qendrore për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë lidhur me problemin e vazhdueshëm të qenve endacakë. AKK-ja organizoi një sërë takimesh me përfaqësues të institucioneve të ndryshme duke kërkuar vazhdimisht veprime konkrete për të gjetur një zgjidhje afatgjatë që do të ishte e pranueshme për të gjitha palët.

Të arriturat

Si rrjedhojë e aktiviteteve dhe kërkesave të vazhdueshme për të ndërmarrë masa konkrete të parashtruara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, AKK-ja së bashku me Agjencionin e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës (AVUK) zhvilluan një studim të fizibilitetit për situatën aktuale në terren. Studimi përfshin një plan veprimi katërvjeçar dhe një plan buxhetor me mbi 1 milion euro për të trajtuar problematikën e qenve endacak. AKK-ja ka dhënë përkrahjen e saj për planin e veprimit të paraqitur dhe u zotua të bashkëpunojë me të gjitha strukturat komunale në përmbushjen e kërkesave që do të dalin nga ky plan veprimi. Përveç kësaj, AKK i dërgoi një kërkesë Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe Ministrisë së Financave duke kërkuar mbështetje financiare për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacakë. Për të minimizuar dhe eliminuar problemin e qenve endacakë, Plani i Veprimit parashikohet të zbatohet në një periudhë kohore prej katër vitesh. Në besojmë se kjo periudhë mund të shërbejë për të krijuar një ndikim të rëndësishëm në zgjidhjen e këtij problemi. Një strategji gjithëpërfshirëse për kontrollin e qenve endacak do të përfshinte: edukimin, reduktimin e qenve endacakë, regjistrimin e qenve dhe pronarëve të tyre dhe licencimin e mbarështuesve dhe strehimoreve private (mbajtësve të qenve). Si përfundim, në mbledhjen e mbajtur me 19 dhjetor 2017 Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa aprovoi kërkesën e AKK-së pas propozimit të Ministrisë së Financave dhe si rezultat u ndanë 1.3 milion euro për fillimin e zgjidhjes së çështjes së qenve endacak.

Impakti

Pas një debati të gjatë për tejkalimin e kësaj situatë drejt një zgjidhjeje përfundimtare për këtë problem dhe përmes lobimit të vazhdueshëm, AKK arriti të bindë Ministrinë e Financave dhe Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa që të ndajë një fond të veçantë në mbështetje të planit të veprimit për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacakë. Kjo është bërë për të mbështetur fazën e parë të një procesi të hartuar për të zgjidhur këtë çështje përmes një programi efektiv dhe gjithëpërfshirës për menaxhimin dhe kontrollin e rrezikut që vijnë nga qenve endacak. Ky rrezik duhet të eliminohet për shkak se ka marrë jetën e një fëmije dhe ka plagosur shumë gra dhe të moshuar në Kosovë. Në besojmë se me implementimin e kësaj iniciative në katër vitet e ardhshme këto rreziqe do të eliminohen.

5. PUNA E KOLEGJIUMEVE PËR SHËRBIME NDAJ KOMUNAVE

5.1. Kolegjiomet Profesionale

Mbeten mbështetje e fortë në diskutimin e projektligjeve dhe akteve të ndryshme nënligjore në interes të komunave, të cilat veçohen në strategjinë legjislativë. Këto mekanizma janë struktura unifikues të pushtetit lokal në Kosovë dhe janë unik për të gjitha shtetet e Evropës Jug-Lindore. Si e tillë, AKK në vete ka edhe 16 asociacione profesionale-një strukturë e paimagjinueshme për shoqata të tjera të ngjashme. Këto kolegjiome

të veçanta merren me shqyrtimin dhe diskutimin e temave të ndryshme të interesit komunal duke përfshirë dhënien e rekomandimeve qeverisë qendrore për të shqyrtuar kërkesat e bëra nga autoritetet komunale për mbrojtjen e kompetencave të tyre dhe përmirësimin e shërbimeve komunale. Kolegjiomet e AKK-së përcaktojnë prioritetet në planet e tyre të punës me qëllimin për të koordinuar dhe zhvilluar aktivitetet e tyre. Ato gjithashtu do të vlerësojnë legjislacionin e vitit 2017 duke identifikuar tema të rëndësishme e të cilat janë në interes të punës së Kolegjiumeve në fushë e tyre përkatëse.

Gjatë këtij viti janë mbajtur përafërsisht nga 6 takime nga secili Kolegjiom (varësisht nga nevoja), dhe 50 takime të kryesive të Kolegjiumeve. Gjatë punës dhe angazhimit të tyre, Kolegjiomet kanë zhvilluar dhe përforcuar qëndrimet e tyre në takime me partnerë dhe bashkëpunëtorë me qëllim dhënien e vërejtjeve dhe sugjerimeve në shqyrtim të akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore gjatë analizimit të kujdesshëm të legjislacionit.

Gjithashtu, duke marrë parasysh që nevoja për trajnime në komuna është e vazhdueshme dhe se ky aspekt nuk është i mbuluar sa duhet nga Institucionet përkatëse të thirrura për të ofruar trajnime, punëtori, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka vendosur që të ndihmojë komunat në mbulimin e fushave të cilat kanë nevojë për trajnime, në identifikimin e nevojave në nivelin lokal si dhe fushat potenciale për të asistuar përmes organizimit -në bashkëpunim me partnerët e tyre të ndryshëm - trajnime për përfaqësuesit e komunave.

Pas diskutimit të temave dhe problemeve të ndryshme në komuna dhe mbështetjes së kolegjiomeve aktuale, është rritur interesi i palëve dhe përfaqësuesve të ndryshëm në formimin e kolegjiomeve të reja. Vlen të theksohet se vendimi dhe aprovimi për themelimin e dy kolegjiomeve të reja si ai për Transparencë dhe Prokurimin Publik ka dërguar në pesëmbëdhjetë numrin e përgjithshëm të kolegjiomeve profesionale të përfaqësuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Në anën tjetër, Kolegjiomet gjatë këtij viti kanë shqyrtuar një mori aktesh nënligjore, të cilat ndërlidhen me zbatimin e ligjeve që rregullojnë kompetencat e komunave. Kolegjiomet i kanë trajtuar aktet nënligjore në aspektin, juridik, financiar, profesional dhe administrativ, varësisht prej fushës që mbulon kolegjiomi e ka trajtuar aktin nënligjor. Gjithashtu, nëpërmjet Kolegjiumeve profesionale është bërë ngritja e kapaciteteve për komunat e Kosovës. Në fillim viti, janë identifikuar shumë tema nga vetë kolegjiomet dhe në bazë të kësaj, AKK ka organizuar trajnime dhe punëtori të ndryshme për disa nga temat e identifikuara si: Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane, - Kujdesi Shëndetësor i Integruar, - Prokurimi elektronik, - Financat lokale, - Shërbimet publike etj. Është e rëndësishme të theksohet se AKK-ja nuk i imponon temat e trajnimeve mirëpo trajnimet organizohen vetëm në bazë të kërkesës së komunave.

Puna e Kolegjiumeve lidhet me zbatimin e legjislacionit në fusha të ndryshme dhe nënkuptohet që zyrtarët komunalë njohin më mirë legjislacionin përkatës për komunat. Kjo i jep AKK-së një pamje më të plotë dhe i mundëson asaj të argumentojë në mënyrë të duhur qëndrimet e saj para qeverisë qendrore gjatë procesit të hartimit të legjislacionit primar ose sekondar. Gjithashtu, pas miratimit të ligjeve dhe akteve tjera nën/ligjore, AKK ka organizuar takime me kolegjiome rreth implementimit sa më të lehtë të këtyre ligjeve dhe akteve tjera nën/ligjore nëpër komuna. Përveç lobimit, avokimit dhe ngritjes së kapaciteteve të komunave, AKK-ja gjithashtu mbështet komunat në implementimin sa më të lehtë të akteve ligjore duke organizuar takime midis përfaqësuesve të ministrive të ndryshme dhe Kolegjiumeve të AKK-së ku diskutohen nene të ndryshme nga ligjet të cilat janë problematike për implementim. Është me rëndësi të përmendet që përmes

Kolegjiumeve të AKK-së, bëhet shkëmbimi i përvojave të mira dhe atyre jo të mira gjatë punës nëpër komuna si dhe organizohen sesione nëpër komuna në versionin "peer to peer learning".

Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor: Duke pasur parasysh përvojën shumë vjeçare të këtij Kolegjiumi dhe rëndësinë që zyrat ligjore kanë në komuna, ky Kolegjium organizon shumë aktivitete. Veprimtaria kryesore e tyre është zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore dhe hartimi i akteve juridike të komunës. Sipas planit të punës për këtë vit, ky Kolegjium përveç se do të shqyrtojë të gjitha projektligjet në aspektin juridik, për të cilat AKK-ja ka paraqitur interesim, ai gjithashtu hartoi edhe disa model-rregullore komunale.

Gjatë këtij viti, Kolegjiumi hartoi "model-rregulloren për varreza dhe mirëmbajtjen e tyre", pasi që një ligj i tillë nuk ekziston në Kosovë, kjo çështje mbetet të rregullohet përmes një rregulloreje komunale.

Po ashtu kryesia e Kolegjiumit së bashku me përfaqësuesin e AKK-së, ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga MAPL-ja, me mbështetjen e OSBE-së, për shqyrtimin e "Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave".

Ky Kolegjium bashkëpunon edhe me kolegjiomet tjera lidhur me ofrimin e këshillave ligjore, apo hartimin e dokumenteve të ndryshme të nevojshme për komunat.

Kolegjiumi ka filluar bashkëpunimin me OSBE-në në aspektin financiar. Është mbajtur edhe punëtorja dy ditore në fund vit për të rishikuar punët që janë kryer gjatë vitit dhe po ashtu është hartuar plani i punës së Kolegjiumit për vitin 2018.

Kolegjiumi i Menaxherëve të Personelit: Me synim harmonizimin e qëndrimeve në projekt rregulloret e reja administrative: 1) procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, 2) procedurat disiplinore në shërbimin civil, 3) procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, ky Kolegjium diskutoi dhe paraqiti qëndrimin e tij për ndryshimet e nevojshme lidhur me disa çështje. Këto çështje kanë qenë kryesisht përkufizimi i rregullave dhe procedurave unike të rekrutimit, përcaktimin dhe klasifikimin e shkeljeve të detyrave të punës, procedurave dhe masave disiplinore që duhet të shqiptohen; si dhe vendosjen e masave në zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në marrëdhëniet e punës së nëpunësve civil si një masë e nevojshme për të krijuar një sistem efikas të menaxhimit administrativ. Një sistem i mirë menaxhimi administrativ është i rëndësishëm për të mbajtur një shërbim civil të qëndrueshëm, efikas dhe profesional.

Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Shërbimet Publike: Pas shumë kërkesave të bëra nga komunat duke u ballafaquar me sfida të vazhdueshme me kompanitë komunale dhe për shkak të mos funksionalitetit të kompanive lokale përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, AKK-ja ka iniciuar ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Për të përmbushur objektivat e përcaktuara, Kolegjiumet përkatëse dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik diskutuan ndryshimet e propozuara në koncept dokumentin mbi Ndërmarrjet Publike, harmonizuan qëndrimet e tyre, ofruan informatat e nevojshëm nga ana e zyrtarëve komunal për problematikat deritanishme dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve në funksionimin e ndërmarrjeve publike komunale.

Kolegjiumi për Arsim: Së bashku me Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës, Kolegjiumi diskutoi problematikat kryesore me të cilat ballafaqohen autoritetet komunale në fushën e arsimit. Për më tepër anëtarët e Kolegjiumit shprehën shqetësimin e tyre para anëtarëve të Komitetit rreth përplasjes së vendimeve të marra nga institucione të ndryshme në lidhje

me çështjet sikurse është ai i inspektorëve të punës dhe inspektorëve të arsimit, pushimet e lehonisë, pagat pas pensionimit të mësimitdhënësve, problemet shëndetësore të mësuesve si dhe udhëzimet dhe vendimet mbi programet e kolegjeve private. Anëtarët e Komitetit u shprehën të gatshëm për të forcuar më tutje bashkëpunimin me AKK-në dhe Kolegjin për Arsim me qëllim të tejkalimit të problemeve dhe gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme në fushën e arsimit. AKK-ja gjithashtu shprehu angazhimin e saj për të avokuar që këto çështje të diskutohen në Kuvendin e Kosovës.

Kolegji për Shërbime Publike: Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Helvetas Sëiss Intercooperation, projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave – DEMOS, organizoi Forumin për Siguri në Trafik: çka duhet të bëjnë komunat në Kosovë? Në këtë forum morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës, Policia e Kosovës, përfaqësues komunal dhe ekspertë të ndryshëm në fushën e komunikacionit. Po ashtu, ky Kolegji ka arritur marrëveshje me GIZ për mbështetjen e krijimit të një grupi punues të Zyrarëve Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (ZKMM), si nën grup në kuadër të Kolegjit për Shërbime Publike.

Kolegji për Shërbime Publike në bashkëpunim me projektin për decentralizim dhe përkrahje komunave – DEMOS, organizoi tryezë diskutimi me temën “Sfidat e komunave për zbatimin e ligjit/vendosjen e rendit komunal në fushën e shërbimeve publike”. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte paraqitja e komunave që kanë praktikën më të mira në fushat kryesore të shërbimeve publike sikurse: 1. zbatimin e rendit komunal – menaxhimi i mbeturinave; 2. fushata për vetëdijesim të qytetarëve si pjesë e projektit për zbatim të ligjit dhe 3. planin për mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale.

Kolegji i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave: Në objektin të përmbushjes së angazhimeve të saj Kolegji i Kryesuesve në bashkëpunim me strukturat e AKK-së është angazhuar në identifikimin e temave më rëndësi dhe në vlerësimin për trajnimet e nevojshme me mundësi të ngritjes së kapaciteteve të anëtarëve të ardhshëm të Kuvendeve të Komunave. Këto trajnime janë të nevojshme për informimin e tyre në menaxhimin dhe identifikimin e prioriteteve mbi çështjet e rëndësishme dhe mbikëqyrjen e punës së komunave.

Kolegji për Buxhet dhe Financa: Organizoi debatet me Kolegjin përkatës sikurse është ai për Arsim, Shëndetësi e Mirëqenie Sociale në diskutimin e koncept dokumentit për financat e pushtetit lokal. Ky koncept dokument është shumë i rëndësishëm pasi iu mundëson komunave që të ushtrojnë kompetencat dhe realizojnë aktivitetet e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Në bazë të diskutimeve me përfaqësuesit komunal dhe me kërkesat e tyre lidhur me funksionimin e komunave në praktikë, ishte e nevojshme ndërhyrja në legjisllacion të financave të pushtetit lokal. Kjo është bërë për të zgjidhur në mënyrë të qëndrueshme funksionet dhe aktivitetet që mundësojnë efikasitet sa më të lartë në fushën e financave lokale. Po ashtu ky Kolegji në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me përkrahje të Misionit të OSBE-së në Kosovë organizoi Forumin me Autoritetet Komunale lidhur me Zhvillimin e Procesit Buxhetor Komunal për vitin 2018-2020. Duke pasur parasysh rëndësinë e planifikimit të buxhetit në nivel lokal, komentet dhe rekomandimet e identifikuar nga ana e përfaqësuesve komunalë në këtë proces konsultativ u përqendruan në: 1.Fleksibilitet në shpenzimet komunale; 2.Fleksibilitet në alokimin e fondeve; 3.Kodi pesë shifror; 4.Respektimi i afateve nga MF-ja në mbylljen e vitit fiskal.

Kolegji i përcaktimit për Planifikim Hapësinor: Në bashkëpunim me Kolegjin për Inspeksion, Kolegji për Planifikim Hapësinor debatoi projekt udhëzimet e reja administrative: 1) projekt udhëzimin administrativ për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve 2) projekt udhëzimin administrativ për mbikëqyrje inspektive dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit; të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejt në punën e komunave sa i përket inspektimit dhe lëshimit të lejeve ndërtimore. Qëllimi i këtyre udhëzimeve administrative është përcaktimi i procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim për shkak të reformave të përgjithshme në lehtësimin e mjedisit për të bërë biznes, duke përfshirë këtu edhe reformat në lëshimin e lejeve ndërtimore.

Kolegji për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Vazhdon të angazhohet në diskutimin dhe harmonizimin e qëndrimeve në projekt udhëzimet e reja administrative. Udhëzimi Administrativ për organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë të Institucioneve të Kujdesit Shëndetësor Parësor (KPSH) u diskutua gjithashtu me ministrin e Shëndetësisë, Z. Rrahmani. Plotësimi i ndryshimit të aktit nënligjor të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare u konsiderua prioritet nga Z.Rrahmani. Të gjitha sugjerimet u përqendruan në respektimin e kompetencave komunale, ngritjen e kapaciteteve si përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Kolegji për Administratë/Buxhet dhe Financa: Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me projektin për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS) organizoi punëtorinë me qëllim prezantimin e procesit të hartimit e deri tek miratimi i rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve në Kuvendet Komunale. U diskutuan përvojat dhe praktikat e ndryshme për shfrytëzimin e subvencioneve për të mirën e grupeve të marginalizuara, si dhe në përmirësimin e politikave të transparencës dhe llogaridhënies në shpenzimin e parave publike.

5.2. Themelimi i Kolegji i reja

Bazuar në pikën 4.3, 4.4 e 4.5 të Strategjisë së AKK-së, si dhe me kërkesë të komunave e zhvillimeve tjera në fushën e qeverisjes lokale, AKK-ja themeloi Kolegjin për Prokurim dhe Kolegjin për Transparencë Komunale.

Kolegji për Prokurim – Ky Kolegji është themeluar duke pasur parasysh rëndësinë e Prokurimit Publik në komuna respektivisht rolin në rritje të zyrtarëve përgjegjës të prokurimit në komuna, dhe në harmoni me objektivat e AKK-së për të avancuar e-qeverisjen në komuna. Ky Kolegji është themeluar edhe me mbështetjen nga projekti USAID - Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM). Qëllimi kryesor i Kolegjit për Prokurim do të jetë të kuptuarit e sfidave me të cilat ballafaqohet sistemi i prokurimit gjatë adresimit të problematikave nga përditshmëria e punës në teren. Kolegji për Prokurim dhe të filloj koordinimin e kujdesshëm me aktivitete të reja përmes ngritjes së kapaciteteve në mbikëqyrjen e

prokurimeve efektive e transparente si dhe pasqyrimin e alternativave të reja përmes propozimeve në funksion të mirëqeverisjes në komuna. Si një proces shumë i rëndësishëm i këtij kolegji vlerësohet nevoja për të ofruar trajnime, për të ngritur aftësinë e tyre afatgjatë për të funksionuar dhe mirëmbajtur sistemin e prokurimit si dhe për të rritur aftësinë e tyre për të trajnuar zyrtarët komunal të prokurimit, duke çuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në procesin e prokurimit komunal. Po ashtu ky kolegji do të ndikojë në rritjen e transparencës dhe konkurrencës në procesin e prokurimit, reduktimin e çmimeve dhe kursimin e parave publike, dhe rritjen e cilësisë së projekteve të financuara me para publike përmes monitorimit dhe udhëzimeve në përmirësimin e shpenzimeve publike. Kjo do të jetë e rëndësishme për ta pasi që do të jenë më produktivë dhe efikasë në kryerjen e punës, e cila shpie drejt transparencës, dhe kthimit të besimit të qytetarëve drejt institucioneve të prokurimit publik.

Kolegji për Transparencë – Ky Kolegji është themeluar me mbështetjen e OSBE-së dhe tashmë ka hartuar Planin Vjetor të Punës dhe kornizat e aktiviteteve të mundshme në vitet e ardhshme. Këtë vit, në bashkëpunim me OSBE dhe DEMOS, Kolegji ka kryer një analizë të re në fushën e transparencës komunale dhe si rezultat i kësaj pritet një akt i ri ligjor nga MAPL për të rregulluar çështjen e transparencës në komuna.

6. Komunikimi

6.1. Komunikimi me Komunitat

Asociacioni i Komunave të Kosovës vazhdoi edhe këtë vit të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunitat. Në këtë periudhë tek komunitat janë dërguar mbi 96 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj.

Për të përmirësuar transparencën, në uebfaqen e AKK-së janë vendosur në baza të rregullta të gjitha botimet dhe broshurat të cilat janë hartuar nga AKK-ja dhe nga disa partnerë dhe bashkëpunëtorë tanë. Zyrtari për IT mirëmban në baza ditore uebfaqen e asociacionit ndërsa statistikave tregojnë që gjatë vitit 2017 uebfaqja e AKK-së ka pasur 47,165 vizita gjithsej, me një mesatare mujore prej 2,143 vizitash. Po ashtu, marrë parasysh publikimet periodike, AKK-ja përpilon dhe shpërndan Buletinin e vet, të vetmin për pushtetin lokal në baza dymujore, e cila publikohet në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht). Në këtë periudhë raportimi janë përgatitur publikuar dhe shpërndarë gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë përmes produkteve identifikuese. Në këtë drejtim AKK-ja ka faqen e vet 'Facebook', ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja. Gjatë vitit 2017 janë mbi 60 postime në 'facebook' me 1500 deri në 2500 'shikime' për postim. AKK-ja ka pasur një rol të madh në këtë drejtim, veçanërisht gjatë takimeve të mbajtura në ngjarjen "Java e Komunave" në muajin qershor.

6.2. Funksionimi i strukturave të AKK-së

Asociacioni i Komunave të Kosovës në këtë gjashtë muor ka përbushur obligimet statutare lidhur me funksionalitetin e strukturave të veta. Janë organizuar disa takime të Këshillit të Kryetarëve, të cilin organ kemi filluar të fuqizojmë edhe më tutje si dhe është mbajtur takimi i Kuvendit të Përgjithshëm, i cili veç shqyrtimit të raporteve vjetore ka debatuar edhe çështjet e lobimit në interes të Komunave të Republikës së Kosovës.

6.3 AKK-ja si mekanizëm që ndihmon edhe nivelin qendror

Duke pasur parasysh se ne jemi shumë të pranishëm me zhvillimet në nivelin qendror, AKK-ja është perceptuar dhe vlerësuar si një mekanizëm që nuk përfaqëson vetëm autoritetet lokale por mund të ndihmojë në çështje të caktuara edhe nivelin qendror. Gjatë këtij viti, ne kemi marrë disa kërkesa nga ministri dhe institucione të ndryshme të nivelit qendror për t'i ndihmuar në organizimin e takimeve të tyre me komunat.

6.4 Trajnimi i anëtarët të rinj të Kuvendeve të Komunave

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) më 11 dhjetor 2017 nisi të zbatoj programin e financuar nga Agjencioni Zvicerianë për Zhvillim (SDC) mbi "Trajnimin e Anëtarëve të zgjedhur të Kuvendeve Komunale". Ky program implementohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Trajnimet organizohen nëpër qendrat regjionale të Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan) ku do të mbahen pesë takime për secilën fushë/temë nga nëntë gjithsej. Në dhjetor janë mbajtur trajnimet për temën e parë dhe të dytë, ndërsa për shtatë temat tjera, trajnimi do të vazhdoj përgjatë muajit janar dhe shkurt 2018.

7. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

Bashkëpunimi i AKK-së me një numër organizatash në pushtetin lokal në Kosovë përcakton dhe inkurajon Asociacionin për një partneritet me këto organizata me të cilat ai koordinon aktivitetet e veta, ngase ndërliidhen punët e përbashkëta me ta. Kjo ndërliidhet edhe me realizimin e pikës 5 të Strategjisë së AKK-së. Bashkëpunimi me partnerët, AKK-së i ka ndihmuar në lobim, avokim, dhe në realizimin e shumë projekteve nga të cilat komunat kanë përfituruar në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. Këto partneritete kanë ndikuar përmirësimin e performancës së komunave, ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme, tejkalimin e mangësive në mungesë të dokumentacionit të kërkuar, bashkëpunimit në mes të komunave me organizata të ndryshme etj.

SDC – Si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së jep kontribut thelbësor në mbështetjen financiare për AKK-në si dhe ka rol kyç në aktivitetet dhe buxhetin e AKK-së. Programi i financuar nga SDC-ja i jep më shumë hapësirë veprimi mbulimit të aktiviteteve të AKK-së, varësisht nga koha dhe nevoja për lobim,

për dallim nga projektet e organizatave tjera. Programi mbështetës i financave nga SDC është gjithëpërfshirës në aktivitetet e AKK-së dhe i integruar me buxhetin bazë.

Miqhtë e AKK-së – Janë mbajtur takime vjetore me partnerët kryesorë të komunave të Kosovës të përfshira në fushën e qeverisjes lokale. Miqtë e AKK-së po funksionon si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve lokale dhe organizatave partnere të tyre. Vlen të theksohet roli kryesor që AKK-ja luan në koordinimin e takimeve dhe aktiviteteve të tyre.

Partneriteti i AKK-së me projekte të ndryshme ndërlidhet në këto aktivitete kryesore:

- Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Organizatën HELVETAS Suiss Intercooperation / projektin DEMOS, ka përkrahur organizimin e trajnimeve në të gjitha komunat me temën “Fuqizimi i rolit të gruas në politikë - Përkrahja e gruas para dhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale gjatë këtij viti”;
- AKK-ja po bashkëpunon me UNDP dhe Agjensionin për Menaxhimin e Emergjencave për projektin SEE URBAN (Ngritja e rrjetit për forcimin e aftësive ripërtëritëse urbane nga fatkeqësitë në Evropën Juglindore), me ç’rast AKK-ja ka prezantuar modelin e rrjetëzimit të Kosovës;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme si vazhdimësi e Konferencës së Ambasadorëve të vitit të kaluar, organizuan Konferencën tematike "Diplomacia e Qyteteve: Qeverisja, zhvillimi lokal dhe marrëdhëniet me jashtë”;
- Në kuadër të partneritetit të AKK-së me organizatat partnere hyn edhe bashkëpunimi me USAID - Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM) në aktivitetet me Kolegjiumin për Prokurim dhe bashkëpunimi me OSBE-në e DEMOS-in me Kolegjiumin për Transparencë.
- AKK-ja ka bashkëpunuar me organizatën gjermane GIZ në fushën e eficientës dhe të menaxhimit të mbeturinave dhe ka arrit marrëveshje për dy projekte në vitin 2018 në këto dy fusha.

8. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E AKK-së

8.1. Përmbledhje e shkurtër

Falë angazhimit të strukturave të AKK-së (administratës dhe nivelit politik), dhe me përkrahjen e partnerëve tanë ndërkombëtarë-sidomos SDC-së, AKK ka arritur që të hyjë në një fazë të re e cila reflekton një qëndrueshmëri të konsiderueshme financiare.

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka si synim të vazhdueshëm ndërtimin e një sistemi të qëndrueshmërisë financiare që garanton ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe statusore të saj. Edhe pse AKK-ja që nga themelimi e deri sot është përballur më vështirësi dhe sfida të shumta që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e saj financiare, ajo arriti që të krijoj jo vetëm një trend pozitiv në krijimin e qëndrueshmërisë financiare, por edhe të ndryshonte perceptimin e komunave për AKK-në. Kjo rezultoi në vendosjen e marrëdhënieve bilaterale të bazuara në mirëbesim reciprok.

Kjo është dëshmuar edhe nga pjesëmarrja masive e komunave në Asamblenë e Përgjithshme të AKK-së, që u mbajt në muajin Mars 2016 dhe anëtarësimit të komunave më shumicë serbe dhe minoriteteve tjera. Përveç kësaj, vlerësimi i punës së AKK-së dhe kënaqshmëria e Komunave anëtare të saj është duke u matur në mënyrë të pavarur nga sondazhet e përgatitura nga organizata gjermane GIZ. Të dhënat nga këto sondazhe janë shumë inkurajuese duke treguar një kënaqshmëri gjithnjë e më të madhe të komunave dhe akterëve të tjerë me punën e AKK-së.

8.2. Të arriturat gjatë vitit 2017

Objektivi i paraparë në buxhetin e AKK-së për vitin 2017 ishte 140,000 €. Brenda periudhës referuese AKK-ja ka realizuar 97 % të objektivit të paraparë, duke mbledhur 137,871 €. Viti 2017 në Kosovë është karakterizuar si një vit elektorale. Gjatë vitit 2017 janë mbajtur zgjedhjet qendrore në muajin qershor dhe ato lokale në muajin tetor. Këto rrethana të reja kanë pasur ndikim negativ në mos përmbushjen në përgjithësi të këtij objekti. Megjithatë në periudhën referuese AKK ka arritur që të ruaj kontinuitetin optimal në realizimin e këtij objekti.

Një tjetër arritje e këtij viti mund të konsiderohet është pjesëmarrja aktive dhe pagesa e rregullt e anëtarësisë nga pesë prej gjashtë komunave të Kosovës me shumicë serbe (Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Novobërda dhe Kllokoti).

Aktivitetet e vazhdueshme të lobimit që kishin për qëllim nxitjen e komunave për të përmbushur detyrimet e tyre financiare ndaj AKK-së, kanë mundësuar që komunat e lartpërmendura të paguajnë tarifën e anëtarësimit. Lobimi u bë përmes mekanizmave të AKK-së, si Kolegji i profesionalëve dhe Këshilli i Kryetarëve që mbledh të gjithë kryetarët e komunave.

Brenda periudhës referuese, Bordi i AKK-së, përkatësisht Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv kanë vazhduar vizitat e rregullta në Komuna përmes të cilave kanë dëgjuar shqetësimet e Komunave për problemet më të cilat ballafaqohen ato. Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së kanë shprehur gatishmërinë e AKK-së për të adresuar të gjitha brengat e Komunave në institucionet përkatëse. Këto vizita kanë shërbyer si një mundësi e mirë për të sqaruar edhe pozicionin financiar të AKK-së si dhe nevojën për një qëndrueshmëri financiare të vazhdueshme.

8.3. Financimi nga palët e treta

Financimi nga palët e treta nënkupton grantet e marra nga AKK-ja përveç atyre të pranuar nga programi i financiar nga SDC. Në këtë drejtim AKK-ja për vitin 2017 ka paraparë një buxhet në total prej €76,000 nga organizata të ndryshme financuese, si NALAS, GIZ, SCI (Save the Children), DEMOS, UNICEF.

Në periudhën referuese, AKK ka arritur të realizoj një pjesë të granteve të parapara, përkatësisht në këtë periudhë AKK ka nënshkruar kontratë me NALAS, në shumë prej € 7,355. Përveç kësaj, brenda kësaj periudhe, AKK ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me organizata si UNDP, OSBE dhe OFAP me të cilat është

paraparë realizimi i aktiviteteve në kuadër të objektivave të përbashkëta me financimin direkt nga ana e këtyre organizatave. Gjithashtu, gjatë vitit 2017, AKK-ja ka negociuar dhe nënshkruar marrëveshje (Memorandum Bashkëpunimi) me organizatën gjermane GIZ në shumë prej 73,365 euro e cilat pritet të implementohet në vitin 2018.